



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR KOMUNËN E MAMUSHËS  
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

**Prishtinë, qershor 2019**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mamushës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Kapllan Muhaxheri* Udhëheqës i Ekipit dhe *Fetah Osmani, Fanol Hodolli* dhe *Arian Zenelaj* Anëtarë, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Luljeta Morina*.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm.....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	11
4 Qeverisja e mirë.....	21
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	24
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	31
Shtojca II: Letër e Konfirmimit.....	34

## Përmbledhje e përgjithshme

Raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Mamushës për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 17/12/2018.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjës

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

#### Theksim i Çështjës

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin, se shpenzimet në vlerë 124,000€ ishin keq klasifikuar, prej të cilave 84,000€ ishin buxhetuar dhe aprovuara me ligjin e buxhetit.

Po ashtu pasuritë jo-financiare me vlerë mbi 1,000€ ishin të shpalosura me gabime.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinionëve, sipas SNISA-ve.

## Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Pasqyrat financiare -Theksimi i çështjes pasqyrojnë dobësitë në kontrole për ta konfirmuar klasifikimin e drejtë të shpenzimeve si dhe shpalosjen e plotë të pasurive.



Kryetari, duhet t'i analizojë arsyet për Theksimin e çështjes në 2018 dhe t'i identifikoj veprimet që kërkohen me qëllim të prezantimit të drejtë dhe të vërtetë të klasifikimit të shpenzimeve, të pasurive për vitin 2018 (shih çështjen C1).

Procesi i përgatitjes së PFV-ve përmbajnë disa gabime financiare, mangësi të shpalosjeve, dhe paqartësi të identifikuar gjatë auditimit.



Kryetari duhet të sigurohet se procesi i përgatitjes së PFV 2019 përfshinë një rishikim përfundimtar të menaxhmentit përgjegjës, dhe deklarata për PFV-të të nënshkruhet vetëm pasi të jenë zbatuar të gjitha veprimet e nevojshme (shih çështjen C1).

Menaxhimi i të hyrave, prokurimit, shpenzimet jo përmes prokurimit, menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, menaxhimin e dosjeve të personelit janë fusha ku kërkojnë përmirësime të mëtejshme.



Kryetari duhet të aplikojnë vlerësim të detajuar të fushave brengosëse të theksuara në këtë Raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe të përcaktoj veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet B1-B5, A1-A3 dhe C2).

Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial ende nuk janë efektive dhe duhet të përmirësohen.



Kryetari duhet ta zbatoj një proces rigoroz për të siguruar që procesi i vetvlerësimit dhe rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/ progreset/ kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore (shih çështjen B6 dhe B7).

## Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase;
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Mamushës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinion i Pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Mamushës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë -LMFPP (i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr.04/L-116 dhe Ligjin nr.04/L-194) dhe Rregulloren MF, nr.01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

#### Baza për opinion

Ne kemi kryer auditim në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

#### Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Për shkak të keq buxhetimit pagesat në vlerë prej 84,000€ ishin bërë nga kategoria e investimeve kapitale, ndonëse për nga natyra këto shpenzime i takonin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Sipas komunës shkaku i një keq klasifikimi të tillë ishte mungesa e buxhetit në kategoritë përkatëse edhe pse ishte bërë aprovimi i buxhetit nga ana e thesarit mirëpo kodet e projekteve ishin keq klasifikuar;

- Përderisa shpenzimet në vlerë prej 40,000€ të buxhetuara si investimet kapitale (projekti mobijle për gjimnaz), janë paguar gabimisht për mallra dhe shërbime nga kategoria jo adekuate sipas planit kontabël. Këto mjete janë shpenzuar për marrëveshjen e bashkëfinancimit me “Caritas Kosova” – aktiviteti “Përkujdesi social shëndetësor shtëpiak dhe ambulator”. Përkundër përshkrimit jo të drejt, më lart, këto mjetet janë shpenzuar për aktivitetin „Asistencë dhe mbështetje në edukim”, në pajtim me marrëveshjen e bashkëfinancimit. Sipas komunës shkak i një keq klasifikimi të tillë ishte planifikimi jo adekuat i buxhetit në kategoritë përkatëse. Pavarësisht arsytetimeve të prezantuara, sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik këto shpenzime nuk plotësojnë kriteret për tu trajtuar si kapitale; dhe
- Pasuritë jo-financiare me vlerë mbi 1,000€ të shpalosura në PFV, nuk janë regjistruar pasuri në regjistrin kontabël- SIMFK. Gjatë auditimit kemi gjetur pagesa të pa regjistruar nga investime kapitale në vlerë 100,702€. Pavarësisht arsytetimeve të prezantuara, si shkak janë ndërrimet e shpeshta në pozitën e zyrtarit të pasurisë dhe neglizhenca e menaxhmentit. Opinioni jonë nuk është i modifikuar për këto çështje.

### **Çështjet kyçe të auditimit**

Si çështje kyçe të auditimit përmendim faktin se:

Komuna e Mamushës ka prezantuar gjendjen e llogarive të arkëtueshme (LL/A) prej 148,000€, një rritje prej 11% krahasuar me vitin paraprak. Në këtë shumë përfshihen të arkëtueshmet nga tatimi në pronë në vlerë prej 96,000€ apo 65%, me një rritje prej 3%, në krahasim me vitin paraprak, që rrezikon financimet e projekteve në të ardhmen nga këto фонде.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV**

Kryetari i Komunës së Mamushës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.



Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr.03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare- nr.01/2013 /MF - Shpenzimi i parave publike dhe 02/2013- Menaxhimi i pasurisë jo financiare në OB;
- Ligji për financat e pushtetit lokal Nr.05/L -108 dhe plotësim ndryshimi Nr. 03/L-049;
- Kërkesat e ligjit të buxhetit për vitin 2018;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet mujore dhe tremujore, raportet operative (të performancës);
- Raportimet tremujore për Kuvendin Komunal dhe diskutimi i raportit të ZKA-së nga KK;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike.

Lidhur me PFV-të e dorëzuara në muajin janar 2019 përveç çështjes tek të arkëtueshmet nuk kemi identifikuar ndonjë çështje tjetër (Neni 16, Raporti për LLA-të, llogaria e tatimit në pronë ishte mbivlerësuar për 3,411€<sup>1</sup>).

Më gjithë përmirësimet e bëra PFV-të ende kishin disa gabime, kryesisht për keq-klasifikimet, si dhe shpalosjet e pasurisë, të cilat i kemi prezantuar tek theksimi i çështjes të opinionit auditimit.

### DEKLARATA E BËRË NGA ZYRTARI KRYESOR ADMINISTRATIV

Marrë parasysh çfarë u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar,, me rastin e dorëzimit të PVF-ve në Ministrinë e Financave mund të konsiderohet e saktë

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

<sup>1</sup> Saldo 93,000€ +35,420€ (faturimi i vitit 2018) -29,009€(arkëtimet)=99,411€ ndërsa janë prezantuar 96,000€ duke i nënvlerësuar për 3,411€.

---

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

**Rekomandimi C1** Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar arsyet për theksim të çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për të adresuar dobësitë e rëndësishme në një mënyrë sistematike dhe pragmatike për të eliminuar dobësitë në klasifikimin e duhur të shpenzimeve të shpalosura në theksimin e çështjes të opinionit të auditimit.

Gjithashtu kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë dhe shpalosjen e drejt të pasurisë, të arkëtueshmeve dhe prezantimin e shpenzimeve. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Mamushës kishte shpenzuar 96% të buxhetit final për vitin 2018, ose me një shumë absolute më të lartë se në vitin paraprak prej 669,962€. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat dhe shpenzimet në përgjithësi janë me të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithëse ne kemi identifikuar disa parregullsi në aspektin e pajtueshmërisë.

Si pasojë e moszbatimit me konsistencë të rregulloreve, duke rezultuar në vlerë të dobët të arritur fushat ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë, menaxhimi i pasurisë si dhe menaxhimi dhe raportimit të llogarive të arkëtueshme. Kjo reflekton një mungesë të mbikëqyrjes së duhur nga komuna në fushat e përmendura.

### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2018 Realizim	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>1,905,053</b>	<b>2,352,228</b>	<b>2,265,753</b>	<b>1,595,791</b>	<b>1,440,614</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,822,650	2,188,236	2,171,303	1,517,996	1,412,667
Të hyrat bartura nga viti paraprak <sup>3</sup>	-	71,604	67,857	71,902	26,742
Të hyrat vetjake <sup>4</sup>	69,186	69,186	17,103	5,893	-
Donacionet e brendshme	-	-	-	-	1,205
Donacionet e jashtme	-	9,985	9,490	-	-
Huamarrja <sup>5</sup>	13,217	13,217	-	-	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 447,175€. Kjo rritje është rezultat i rritjes të grantit qeveritar për 365,586€, bartjes së të hyrave nga viti paraprak 71,604€, si dhe fondet nga donatorët të jashtëm për 9,985€. Krahasuar me planifikimi final, komuna kishte arritur ta shpenzon buxhetin në masë prej 96%.

#### Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>1,905,053</b>	<b>2,352,228</b>	<b>2,265,753</b>	<b>1,595,791</b>	<b>1,440,614</b>
Pagat dhe Mëditjet	932,000	897,586	897,586	834,645	856,690
Mallrat dhe Shërbimet	234,308	233,625	218,930	178,130	227,852
Shërbimet komunale	23,000	27,004	24,037	22,819	22,953
Subvencionet dhe Transferet	6,466	407,666	406,036	6,350	2,400
Investimet Kapitale	709,279	786,347	719,164	553,847	330,719

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>3</sup>Të hyrat vetjake të pashpenzuara të komunës në vitin paraprak dhe të bartura në vitin aktual.

<sup>4</sup> Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

<sup>5</sup> Huamarrja nga banka botërore (për drejtorin e Arsim).

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim ;

- Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar për investime kapitale, ishte rritur për 77,068€ ndërsa gjatë vitit 91% e buxhetit ishte shpenzuar. Gjithashtu, vlen të theksohet se në periudhën e fund vitit janë lidhur 47% kontratave apo 22 kontrata në vlerë 764,819€ nga 47 kontratat e tërësishme të nënshkruara gjatë vitit 2018 në vlerë prej 1,090,530€. Po ashtu edhe dinamika e realizimit nuk është në harmoni me planifikimet sepse 99% e shpenzimeve nga kjo kategori janë realizuar në tre-mujorin e fund vitit. Kjo mund të reflektoj me mungesë të kontrolleve për shkak të volumit të pagesave në periudhën e fund vitit.
- Tek kategoria e pagave dhe mëditje, buxheti final ishte kursyer për 34,414€<sup>6</sup> ( në bazë të vendimit të Qeverisë) krahasuar me buxhetin fillestar dhe ishte shpenzuar në nivel 100% e buxhetit final;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar nuk ka ndryshuar krahasuar me buxhetin fillestar, ndërsa niveli i realizimit është prej 94%, po ashtu vlen të theksohet se edhe obligimet në këtë kategori janë zvogëluar për 6,000€ (nga 16,000€ sa ishin në vitin 2017, në 10,000€ në fund të vitit 2018);
- Buxheti final për shërbimet komunale ka pasur një rritje prej 4,000€ krahasuar me buxhetin fillestar dhe komuna ka arrit të shpenzojë 89% të buxhetit për këtë kategori, ndërsa obligimet në këtë kategori janë rritur për 3,000€;
- Buxheti final për subvencione në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 401,200€, kjo rritje ka rezultuar nga transferet e bëra nga Qeveria e Republikës së Kosovës për vërshimet dhe fatkeqësitë tjera të ndodhura në Komunën e Mamushës gjatë vitit 2018, dhe ka arritur të shpenzojë 99% të buxhetit për këtë kategori. Po ashtu vlen të theksohet se obligimet në këtë kategori janë rritur për 4,000€;
- Komuna ka pranuar gjithashtu grante nga donatorët të jashtëm në vlerën prej 9,985€, që gjatë këtij vitit ishin realizuar 95%. Po ashtu vlera prej 13,217€, e cila ishte nga huamarrja për Drejtorin e Shëndetësisë, dhe nuk kishte filluar për tu shpenzuar gjatë këtij viti.

### 3.1.1 Të hyrat

Pranimi i të hyrave për vitin 2018 ishte 56,177€, apo krahasuar me vitin e kaluar komuna ka arkëtimit më të lartë të të hyrave vetjake prej 13,379€ apo shprehur në përqindje 31% më shumë. Ndërsa në krahasim me planifikimin, komuna gjatë kësaj periudhe kishte arritur të pranonte të hyra në masën 88%. Ndërsa nëse kemi parasysh edhe të hyrat indirekte, realizimi i të hyrave krahasuar me planifikimin është 106%.

Si kategori dominuese në strukturën e të hyrave vetjake është arkëtimi i të hyrave nga tatimit në pronë, rreth 52% apo 29,009€ me një rritje prej 51% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

<sup>6</sup> Vendimi i qeveris me nr.07/80 i datës 18.12.2018 për kursime buxhetore nga kategoria e pagave në vlerë prej 34,414€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
<b>Të hyrat vetjake</b>	<b>69,186</b>	<b>69,186<sup>7</sup></b>	<b>56,177</b>	<b>42,798</b>	<b>56,243</b>

Përveç të hyrave të prezantuara në tabelë, komuna ka pranuar të hyra nga dënimet e policisë, dhe gjobat e gjykatave në vlerë 17,025€.

Nga të hyrat që komuna kishte në posedim gjatë këtij viti në vlerë prej 144,806€ janë shpenzuar të hyrat në vlerë prej 84,960€ (kryesisht për projektet kapitale 98 % apo 83,396€), dhe komuna ka bartura në vitin e ardhshëm fondin e të hyrave të pa shpenzuar në vlerë prej 59,846€.

### Çështja B1- Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë

#### Gjetja

Zyra komunale e tatimit në pronë është e obliguar që çdo vit të bëjë verifikimin (ri-anketimin) në teren të 1/3-ës së pronave të regjistruara, siç kërkohet me Ligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.03/L-204 si dhe Ligji me nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshëm tek neni 15 pika 2 citohet se veprimtarit inspektuese kryen çdo vit për të paktën 20% e të gjithave objekteve të komunës dhe vetëm kur është e nevojshëm për parcelën, dhe udhëzimin administrativ në fuqi. Komuna gjatë vitit 2018 nuk ka filluar me verifikimin (ri anketimin apo inspektimin) në teren të pronave të regjistruara. Mos azhurnimi i sistemit me të dhëna (verifikim të pronave apo inspektimi), ishte si pasojë e mungesës së zyrtarëve anketues në terren si dhe;

Gjithashtu, sipas nenit 9 të ligjit nr. 03/L-204, çdo person fizik, i cili më datën me 1 mars ose para 1 marsit të një periudhe tatimore vendos se prona ose njësia e banimit i shërben si vend kryesor për banim, i lejohet zbritja prej (10,000€) nga vlera e tatueshme e pronës. Nga 10 mostrat e testuara, në pesë (5) raste komuna nuk kishte vepruar në përputhje me ligjin për arsye se kishte tatimpagues që posedonin dy apo më tepër prona të regjistruara për banim kryesor dhe për secilën pronë, është aplikuar zbritja prej 10,000€. Gjithashtu, nga analizimi i bazës së tatimit në prone (protaxi nga komuna) kemi vlerësuar se rreth 14 prona (nga 602 prona të evidentuar për banim), komuna ka lejuar zbritjen e parregullt. Efekti i këtyre zbritjeve të parregullta ndikon që komuna të ketë ngarkesa tatimore me të ulëta në vlerë të përafërt prej 224€, gjegjësisht të hyrat me të pakta nga tatimi në pronë. Edhe pse efekti financiar nuk është material një gabim i tillë ka pasur mundësi të eliminohet dhe korrigjohet me kohë. Zyrtaret përgjegjës komunal të tatimit në pronë nuk i kanë modifikuar apo raportuar me kohë gabimet të zyrtarët e nivelit qendror për korrigjimet e duhura.

<sup>7</sup> Përfshihet edhe planifikimi i të hyrave nga gjobat në trafik dhe gjobat e gjykatave (5,000€).

**Rreziku** Mos verifikimi i 1/3 të pronave apo inspektimi i 20% i pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe mungesa e kontrolleve efektive në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë do të vazhdojë të rezultojë me shkallë të ulët të arkëtimit, si dhe komuna i ekspozohet humbjes së besimit për trajtim të drejt të tatimpaguesve.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parasheh ligji në mënyrë që në bazën e të dhënave të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale të pronat të vlefshme për bazën e tatueshme si dhe duhet të vendos kontrolle të qëndrueshme që sigurojnë një arkëtim efektiv të të hyrave, duke përfshirë dhe përcaktuar vlerësimin e drejtë të barrës tatimore në përputhje me rregullat dhe gjendjen faktike në teren.

### 3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte prej 897,586€, ndërsa shpenzimet ishte prej 100%.

Numri i stafit të miratuar ishte 136 punonjës, ndërsa numri aktual i punonjësve është 134 punonjës. Ne kemi audituar procedura të rekrutimit si dhe dosjet e personelit për të verifikuar rregullsinë e tyre.

#### Çështja A1- Mungesë e dosjeve të personelit dhe kompensimi i shtesës pa bazë ligjore

**Gjetja** Për shtatë (7) zyrtarë të cilët janë të angazhuar në Drejtorinë për Emergjencë dhe Siguri, komuna nuk ishte në gjendje të na ofrojnë dosjet e kompletuara dhe kontratat e këtyre zyrtarëve, në bazë të cilave kryhet kompensimi i pagave. Sipas menaxherit të personelit nuk ka dokumentacion relevant për këta zyrtar dhe kjo dukuri është shfaqur si pasojë e një memorandumi të nënshkruar vite me parë, pasi që zyrtarët janë pjesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa kompensimi i pagave dhe kompensimet e tjera kryhen nga komuna. Kjo pasqyron një mungesë të specifikave të qarta për Burimet Njerëzore të Komunës.

Po ashtu Qeveria e Kosovës në bazë të vendimit me Nr. 11/26 i datës 19/05 2010 precizon, të gjithë të kategorizuarit si nëpunës civil sipas Ligjit për Shërbimin Civil do të përfitojnë mjete financiare në baza mujore në vlerë prej 30€ bruto. Sipas të dhënave të kërkuar nga sektori i MPB kemi identifikuar se këta zyrtar nuk janë të kategorizuar si nëpunës civil, ndërsa kompensohen me shtesën prej 31.2€ për muaj, që në total gjatë vitit 2018 janë kompensuar në vlerë prej 2,621€. Gjendja e tillë ishte shfaqur sepse zyrtarët janë pjesë e stafit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si pasojë e memorandumit.



**Rreziku** Pagesat për zyrtarët në mungesë të dokumentacionit relevant, rezultojnë në pamundësinë për të justifikuar pagën/shtesat ose për të mundësuar shqyrtimin e rezultateve nga vlerësimet e performancës, po ashtu pagesat e shtesave në kundërshtim me vendimin e qeverisë, janë pagesa të parregullta dhe shkaktojnë dëmtim të buxhetit të komunës.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të adresojë çështjen e mëtejme të këtyre pagesave, në MAP dhe MF ose të sigurojë rishikimin e mundësisë që këta zyrtarë të transferohen në institucionet ku ata punojnë, ose të kompletohen dosjet e tyre në komunë për të krijuar bazë ligjore për kompensimin e pagave.

### Çështja C2- Dosjet e pa azhurnuara të personelit

**Gjetja** Bazuar në vendimin e Qeverisë Nr. 06/29 i datës 15.05.2015, për dëshmimin e përvojës së punës kërkohet një vendim i vërtetuar nga zyrtarët e autorizuar të personelit. Nga pesë (5) mostrat e testuar, në dy (2) raste dëshmitë për vitet e përvojës së punës të stafit mësimdhënës në drejtorinë e arsimit nuk ishin të pasqyruara në një vendim të vërtetuar nga zyrtarët e autorizuar të personelit, si bazë për pagesat e përvojës së punës. Shkaku i një dukurie të tillë ishte mos koordinimi në mes të shkollave dhe drejtorisë së arsimit.

**Rreziku** Pagesat të punonjësve pa një pasqyrë të dëshmimeve të besueshëm dhe të mjaftueshme të përvojës së punës, të kontrolluar dhe autorizuar nga stafi kompetent, rrisin rrezikun e kompensimit jo real të shtesës për përvojën e punës. Mos kompletimi i dosjeve të personelit shpie në rrezikun e pagesave të parregullta dhe hapjen e kontesteve gjyqësore.

**Rekomandimi C2** Kryetari të sigurohet se drejtoret e institucioneve arsimore, kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës.

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra, shërbime dhe komunalitet në vitin 2018 ishte 260,629€. Prej tyre ishin shpenzuar 242,967€, apo 94%.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.



### 3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 407,666€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 406,036€ ose shprehur në përqindje 99% e buxhetit, ato kanë të bëjnë me subvencionimin e lehonave. Ndërsa subvencionet mbi dëmet e shkaktuara nga vërshimet gjatë vitit mjetet janë siguruar dhe të transferuara nga Qeveria.

#### Çështja B2 - Mungesa e rregullores për subvencione

**Gjetja** Neni 36 i Rregullës financiare 01/2013 - "Shpenzimi i parave publike", thotë: "Për çdo pagesë të subvencionit apo transferit duhet të ketë bazë të qartë juridike, d.m.th duhet të ketë ligj, rregullore ose vendim të institucionit përkatës që i mundëson organizatës specifike buxhetore ta bëjë një pagesë nga kjo kategori". Komuna ende nuk ka bërë hartimin e Rregullores së brendshme për subvencione. Në mungesë të rregullores, subvencionet janë ndarë në bazë të vendimeve të Kuvendit të Komunës dhe që të gjitha shpenzimet ishin bërë për subvencionimin e lehonave.

**Rreziku** Mungesa e rregullores së brendshme për ndarjen e subvencioneve krijon paqartësi në përcaktimin e kriterëve për përfituesit e subvencioneve. Kjo rritë rrezikun që subvencionet të mos arrijnë qëllimin e tyre.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të siguroj hartimin e një rregullore për procesin e subvencionimit të gjitha aktiviteteve, dhe e cila specifikon qartë kriteret për subvencionim dhe e njëjta të aprovohet në Kuvend Komunal.

### 3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti aktual për kategorinë e Investimeve Kapitale është: 786,347€ ndërsa shpenzimet përgjatë vitit 2018 janë: 719,164€ ose shprehur në përqindje 91.5% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve, kanalizimeve, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore, etj. Krahasuar me vitin e kaluar, vërehet performancë më e mirë e ekzekutimit të buxhetit për këtë kategori në vlerë prej 165,317€ apo rreth 30% më shumë.

#### Çështja A2 - Tejkalimi i pozicioneve të paramasës së kontraktuar

**Gjetja** Sipas Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik përkatësisht nenit 61.20 pika g dhe h "Funksionet e Menaxherit të Projektit janë: të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës; t'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës nga ana Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin.

Nga auditimi i 35 pagesave për qëllime të pajtueshmërisë kemi identifikuar se në katër (4) raste komuna kishte ekzekutuar pagesën për pozicionet të cilat ishin tejkualuar krahas paramasës së kontraktuar por pa tejkualuar vlerën totale të kontraktuar. Pra Organi mbikëqyrës përkatësisht menaxheri i kontratës nuk kishte respektuar paramasën dhe parallogarinë si aneks e kontratës bazë. I njëjti nuk kishte respektuar procedurat ligjore me rastin e ndryshimit/tejkualimit të pozicioneve pasi që nuk kishin kërkuar aprovim për ndryshimin e pozicioneve nga ana e Menaxherit të prokurimit dhe ZKA. Vlera totale e pagesave, situacionet e të cilave kishin tejkualuar pozicionet është: 62,260€. Planifikimi dhe hartimi jo-adekuat i projekteve ekzekutive nga ana e autoritetit kontraktues, ka shtyrë që të ndryshohen pozicionet brenda paramasës së kontraktuar. Gjithashtu, neglizhenca nga ana e menaxherit të projektit ka bërë që mos të ndiqen procedurat përkatëse ligjore me rastin e tejkualimit të pozicioneve.

**Rreziku** Tejkualimi i pozicioneve të përcaktuara paraprakisht në marrëveshje kontraktuale pa ndjekur procedurat ligjore përbën shkelje të kontratës dhe si e tillë rritë rrezikun që operatori të mos kryej punët sipas standardeve dhe cilësisë së përcaktuar në paramasë.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurohet që fillimisht projektet ekzekutive janë të qëndrueshme dhe të planifikuara mirë, në mënyrë që mos të lejohen tejkualime-ndryshime të pozicioneve të para masave paraprakisht të kontraktuara. Në të kundërtën çdo ndryshim jashtë procedurave ligjore përbën shkelje të kontratës nëse paraprakisht nuk sigurohet miratimi nga menaxheri i prokurimit dhe ZKA.

## 3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë të pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj. Vlera e pasurisë e paraqitur në PFV-të 2018 ishte prezantuar prej 3,082,672€ kurse në regjistrin e SIMFK janë prezantuar vetëm 45,792€ nga pasuria mbi 1,000€.

Të gjitha çështjet domethënëse rreth pasurisë janë trajtuar në seksionin 2.1 Opinioni për Pasqyrat Vjetore Financiare.

### Çështja B3 - Mungesa e procedurës së brendshme dhe regjistrit të pasurisë nën 1,000€

**Gjetja** Neni 9 i Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë financiare i obligon organizatat buxhetore të regjistrojnë pasuritë jo financiare ku pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin E-pasuria. Gjithashtu Neni 4.1 i Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë financiare thekson se "Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për

evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare”.

Bazuar në rregullat e lart cekura kemi identifikuar se sistemi i E-pasurisë nuk funksionon dhe komuna nuk ofron regjistër të pasurisë nën 1,000€, siç është paraparë në nenin 6, të rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive financiare. Shkaku i mos regjistrimit të pasurisë nën 1,000€ ishte mos përdorimi i sistemit-të E-pasurisë. Komuna ende nuk ka hartuar procedura të brendshme për menaxhimin e pasurisë përkundër që ishte rekomandim në raportin e vitit të kaluar.

#### **Rreziku**

Mos regjistrimi i plotë të pasurisë siç kërkohet me rregullore, mund të rezultojë që komuna të mos identifikoj gjendjen reale dhe faktike të pasurive të cilat mund ti ekspozohen humbjes apo tjetërsimit. Mungesa e procedurave të brendshme për ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë mund të ndikoj që pasuria e komunës mos të menaxhohet si duhet dhe mos të prezantohet drejtë në pasqyrat financiare.

#### **Rekomandimi B3**

Kryetari duhet të siguroj se procesi gjithë përfshirës i regjistrimit të pasurive do të vazhdoj dhe brenda një afati optimal dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e tyre duhet të aplikohen në tërësi, të siguroj një evidencë të saktë të inventarit, të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme me vlera nën 1,000€ të bëhen përmes sistemit E-pasuria dhe të siguroj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare.

### **3.3 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj**

Ne këtë kapitull auditori ka trajtuar mbledhjen e të hyrave deri në 10€ dhe depozitimin e këtyre të hyrave në bankë.

#### **Çështja B4 - Depozitimi i vonuar i parasë së gatshme**

##### **Gjetja**

Neni 11 i Rregullës Financiare 03/2010, për të hyrat, citohet: “Paratë e grumbulluara në vlerë deri në 10€ nga arkat e OB-ve në fund të ditës duhet të depozitohen (në llogari bankare zyrtare), total për çdo lloj të të hyrave me faturë përmbledhëse me numrin identifikues UNIREF”. Komuna në dy (2) raste, paratë e grumbulluara nga arka e administratës së komunës në vlerë prej 150€ (prej datës 13/06/2018 deri me datën 04/07/2018) dhe shumen prej 266€ (të arkëtuar prej datës 10/02/2018 deri me datën 23/02/2018), i ka deponuar në llogarinë komunës me vonesë prej 1 deri 21 ditë, ndërsa në rastin tjetër prej 1 deri 13 ditë. Sipas zyrtareve një dukuri e tillë ndodhë për shkak të shpenzimeve gjatë deponimit.

**Rreziku** Depozitimi i vonuar i parasë së grumbulluar rritë rrezikun e keq përdorimit të parasë publike. Gjithashtu kjo shpie te raportimi jo i drejtë i të hyrave sipas periudhës kohore. Përveç kësaj, një praktikë e tillë nuk është në pajtueshmëri me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

**Rekomandimi B4** Kryetari të sigurohet se kontrollet janë vendosur dhe funksionojnë bazuar në kërkesat ligjore dhe arkatarët apo zyrtarët kompetent që mbledhin paratë publik si të hyra ti depozitojnë brenda afateve të parapara ligjore.

### 3.4 Të arkëtueshmet

Lista e debitorëve ndaj komunës, sipas të dhënave në PFV është 148,000€. Pjesa më e madhe e tyre kanë të bëjnë me tatimin në pronë 96,000€, ndërsa pjesa tjetër nga Taksa në Firmë.

#### Çështja B5 - Rritja e nivelit të të arkëtueshmeve

**Gjetja** Bazuar në prezantimin e llogarive të arkëtueshme në PFV, komuna ka shpalosur rritje të nivelet të këtyre llogarive krahasuar me vitin paraprak prej 11 %. Edhe pse komuna përballet me llogari të pa arkëtuar dhe rritje të tyre nga viti në vit ende nuk ishte hartuar apo aplikuar ndonjë politikë adekuate në mbledhjen e të arkëtueshmeve nga vitet paraprake, në veçanti nga tatimi në pronë, si dhe borxhet nga taksa në firmë. Shkaku i një dukurie të tillë është mungesa e mekanizmave adekuatë nga ana e komunës për t'i arkëtuar këto të hyra. Përpos aplikimit të vërejtjeve si masë e përdorur nga komuna, mungonin veprime të vazhdueshme si inicimi i procedurave për arkëtim të detyrueshëm të borxheve nëpërmes organeve tjera kompetent.

**Rreziku** Mungesa e mekanizmave ka rezultuar me vlerë të lartë të të arkëtueshmeve që rrisin rrezikun e vjetërsimit të këtyre llogarive si të pa mbledhshëm me kohë si dhe reflektojnë në mos përmbushjen e planit të shpenzimeve.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet .

### 3.5 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve nga 16,748€ sa ishin në fund të vitit 2017 kanë shënuar një rritje simbolike dhe gjatë vitit 2018 janë prezantuar në vlerë prej 16,785€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019.

#### Çështja A3 - Mos ekzekutimi i pagesave në afatin ligjor

**Gjetja** Sipas Rregullës Financiare 01-2013 MF- Shpenzimi i parave publike OB duhet që çdo faturë të vlefshme për pagimin e mallrave dhe shërbimeve të pranuar ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimin të faturës. Nga pesë (5) mostrat e testuar në vlerë prej 8,712€ kemi identifikuar se në dy raste në vlerë prej 6,873€ kishte tejkalim të afatit ligjor për pagesën e obligimeve. Shkaku i kësaj ishte mungesa e mjeteve.

**Rreziku** Si pasojë e vonesave të pagesave dhe mungesës së informacioneve të plota mund të dobësohet aftësia e komunës për të parashikuar dhe menaxhuar nevojat për likuiditet. Po ashtu, komuna mund të përballlet me kosto shtesë të interesave e gjobave për vonesat në pagesa.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave për të siguruar që faturat paguhen brenda afatit ligjor.

## 4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimit e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

## Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ne kemi vlerësuar disa aktivitete që mund t'i kontribuojnë një qeverisje të mirë, si dhe mundësitë ekzistuese për përmirësim të mëtejshëm si në vijim:

Në qeverisjen lidhur me aktivitetet operationale dhe financiare në komunë, ende mbetin fusha ku nevojiten veprime të rëndësishme. Përgjigjet efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm, zhvillimi mbi proceset e menaxhimit të rrezikut, si dhe menaxhimi i pasurisë komunale janë disa nga fushat të cilat komuna duhet dhënë prioritet sa i përket një qeverisjeje më efektive.

Një progres në menaxhimin e organizatës, kryesisht në arkëtimin në realizimin e buxhetit, në shlyerjen e borxheve të prapambetura, si dhe veprime të konsiderueshme janë ndërmarrë në ndërtimin e marrëdhënieve kontraktuale me donatorë të ndryshëm. Për shumicën e aktiviteteve komunale ka një komunikim dhe raportim të mirë mes bartësve të njësive dhe kryetarit. Pyetësi i vet-vlerësimit i plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese.

Mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i jashtëm. Përgjigja efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve nuk është e kënaqshme. Kjo pjesë është trajtuar më hollësisht tek kapitulli 'Progresi i zbatimit të rekomandimeve'.

Komuna nuk e kishte hartuar planin strategjik të zhvillimit si dhe ende mungonin planet tjera strategjike si: planet hapësinore, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj.

Në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, auditimi ynë ka shpalosë ekzistencën e disa dobësive si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve të cilat përfshijnë kryesisht menaxhimin e pasurive, të hyrat, subvencionet dhe të arkëtueshmeve.

### 4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Komuna nuk ka të themeluar NjAB dhe nuk ka siguruar shërbime të auditimit të brendshëm për të identifikuar mangësitë në sistem.

#### Çështja B6 - Mos themelimi i NJAB-së

##### Gjetja

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik, secili subjekti publik me buxhet 1 deri 3 milionë duhet të ketë një auditor të brendshëm.

Komuna nuk ka bërë përpjekje të siguroj themelimin e NjAB-së ose që shërbimet e auditimit të brendshëm t'i siguroj nga bashkëpunimi me ndonjë organizatë tjetër buxhetore. Si shkak i mos themelimit të NJAB, ishte kufizimi buxhetor për rekrutim të stafit.



**Rreziku** Mungesa e auditimit të brendshëm mund të rezultojë me vazhdimin e përsëritjes së dobësive në sistemet kyçe të kontrollit të brendshëm. Për më tepër, menaxhmenti mund të mos i identifikojë dhe reagojë me kohë ndaj parregullsive dhe dobësive të kontrollit.

**Rekomandimi B6** Kryetari duhet të siguroj përmbushjen e kërkesës ligjore, respektivisht të rekrutoj një auditor të brendshëm. Nëse kjo kërkesë nuk mund të realizohet, atëherë shërbimi i auditimit të brendshëm, të kryhet nga Ministria e Financave, apo ndonjë subjekt tjetër publik. Shërbimi i auditimit, do të mbështeste menaxhmentin në vendimmarrje dhe eliminim të dobësive.

## 4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalesje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë edhe më teje në disa fusha jo efektive dhe nuk mundësojnë veprime efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë: Vazhdimi i regjistrimit i pasurive komunale, klasifikimi i drejtë i shpenzimeve, menaxhimi i të arkëtushmeve.

### Çështja B7 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

**Gjetja** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ndonëse ofruan dëshmi që menaxhmenti posedon analiza të rregullta për ecuritë buxhetore, takimet ende nuk ishin të formatizuara për të konfirmuar që menaxhmenti i rishqyrton raportet financiare mbi shpenzimet dhe të hyrat dhe operacionet tjera të komunës. Komuna ka hartuar regjistër të rreziqeve, mirëpo nuk ka përgatitë një strategji për menaxhimin e rrezikut. Edhe pse ekziston mundësia e përballjes me rreziqe, komuna nuk ka ndërmarr veprime të nevojshme për të përgatitë ndonjë politikë, procedurë apo raport se si do të menaxhohen rreziqet, në veçanti rreziku i mashtrimit dhe parregullsive.

**Rreziku** Mos azhurnimi i raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti ilartë redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e komunës në mënyrë pro aktive si dhe ulë efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo, gjithashtu, mund të ndikoj që të hyrat të mos arkëtohen siç pritet, njëjtë mund të rezultojë në ofrimin e shërbimeve të dobëta.

**Rekomandimi B7** Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili mund të nxirren të gjitha informatat relevante që ndikojnë në vendimmarrjen cilësore dhe me kohë të menaxhmentit. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe zbatimi i planit të prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit.

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të Komuna e Mamushës ka rezultuar në 16 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Më tutje, komuna nuk kishte ndjekur ndonjë proces formal për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për zbatimin e tyre. Kjo ka ndikuar që vetëm një pjesë e rekomandimeve të zbatohen dhe të përsëriten mangësitë e njëjta në disa fusha. Kuvendi Komunal i Mamushës nuk ka shqyrtuar diskutuar raportin e auditimit të ZKA-së për vitin 2017. Pjesa më e madhe e rekomandimeve kanë mbetur në proces të zbatimit, ose të pazbatuar.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar, dy (2) janë në proces, një (1) i mbyllur, dhe shtatë (7) nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018**

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	<p>Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar arsyet për kualifikimin e opinionit të auditimit dhe paragrafin e theksimit të çështjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të eliminuar gabimet në prezantimin e buxhetit dhe të të hyrave vetjake, si dhe evidentimin dhe raportimin e pasurisë.</p> <p>Gjithashtu, kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.</p>	Janë marrë veprime konkrete komuna ka arritur në masën e madhe të bëjë për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të eliminuar gabimet në prezantimin e buxhetit dhe të të hyrave vetjake si dhe shpalsjen dhe raportimin e obligimeve. Por edhe gjatë këtij viti kemi mos regjistrimin e pasurisë dhe shpalsjen e drejtë të të arketushmeve.	Pjesërisht është zbatuar.
2	Nivel i ulët i realizimit të buxhetit të investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.	Komuna e Mamushës ka një performancë të mirë në realizimin e buxhetit dhe kishte arritur për të shpenzuar 96% të buxhetit final për vitin 2018.	Është zbatuar.
3	Menaxhim jo adekuat i të hyrave nga tatimi në pronë	Kryetari duhet të sigurojë se verifikimi të bëhet në baza të rregullta vjetore sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, që reflekton shënime të përditësuara të regjistrit dhe ngarkesave të sakta tatimore.	Në mungesë të zyrtareve të tatim paguesve në teren edhe gjatë këtij viti nuk ka arritur të verifikoj gjegjësisht të inspektoj pronat në bazë të dispozitave në fuqi.	Nuk është zbatuar.

4	Mungesë e dokumentacionit relevant në dosjen e personelit	Kryetari i komunës duhet të siguroj se para skadimit të kontratave të punëtorëve të fillohet me procedurat e rekrutimit apo nëse paraqitet nevoja për vazhdimin e kontratave, procedurat e vazhdimin të jenë në përputhje me rregullat dhe udhëzimet në fuqi. Po ashtu në bashkëpunim me drejtoret e shkollave duhet të sigurohet që stafi i angazhuar të ketë kualifikimin e duhur si dhe dëshmitë valide që vërtetojnë nivelin e tyre.	Gjatë këtij viti nuk kemi vrenjtur që zyrtarëve që ju ka kaluar kontrata, si dhe angazhimit të stafit pa kualifikim, por kemi vërejtur se dosjet e personelit nuk janë plotësisht të kompletuar i mungon vërtetimi i përvojës së punës në dosje.	Pjesërisht është zbatuar.
5	Parregullsi në angazhimin e stafit për shërbime të veçanta dhe detyra specifike	Kryetari duhet të siguroj që punonjësit përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Ndërsa për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se buxhetohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si dhe paguhen nga sistemi i pagave.	Numri i stafit të angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta është eliminuar.	Është zbatuar.
6	Mos arsyetimi i avanseve si dhe kodifikimin i gabuar i shpenzimeve	Kryetari duhet të rishikoj kontrollet ekzistuese në lidhje me pagesat në avanse dhe të vendos kontrolle për të mbështetur validitetin e tyre. Po ashtu të sigurojë shpenzimet evidentohen sipas planit kontabël dhe shpenzimet regjistrohen nëpër kodet përkatëse.	Avanset mbyllen në afatin ligjor.	Është zbatuar.
7	Mungesa e rregullores për subvencione	Kryetari duhet të hartoj një rregullore e cila specifikon qartë kriteret dhe procedurat për subvencionim dhe e njëjta të aprovohet në Kuvend Komunal.	Edhe gjatë këtij viti nuk është hartuar rregullorja për subvencione.	Nuk është zbatuar.
8	Dobësi sistematike në menaxhimin e kontratave	Kryetari duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për përfundimin e projekteve të cilat po përcjellën në vazhdimësi. Po ashtu në të ardhmen duhet të sigurojë se para inicimit të projekteve fillimisht të zgjidhen çështjet e shpronësimeve, dhe problemeve tjera të identifikuar në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve.	Gjatë këtij viti nuk kemi vërejtur vonesa në përfundimin e punimeve edhe pse janë kryer testime shtesë edhe gjatë testimit të indikatorëve të performances nga kjo sferë.	Është zbatuar.
9	Ndarje jo adekuate e detyrave, dhe mos	Kryetari duhet të siguroj ndarje të drejtë të detyrave, kontrolle adekuate mbi pranimin e mallrave/shërbimeve para ekzekutimit të pagesave, si dhe duhet të sigurojë se zyrtari	Një përshkrim me detajuar e kemi vërejtur me rastin e certifikimit të	Është zbatuar.

	përshkrimi i raportit standard të pranimit	i pranimit bën përshkrimin e mallit/punës të pranuar me qëllim të konfirmimit se furnizimet/punët janë pranuar konform kontratës nga ana e zyrtarëve kompetent.	lëndëve nga zyrtari i pranimit të mallit.	
10	Mungesa e regjistrimit të pasurive	Kryetari duhet të ndërmerr masa të menjëhershme për të regjistruar të gjitha pasuritë e saj. Pasuritë mbi 1,000€ duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në SIMFK, ndërsa pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin e-pasuria. Në fund të vitit, para hartimit të pasqyrave financiare duhet të kryhet procesi i inventarizimit i cili duhet të harmonizohet me regjistrat e pasurisë dhe nëse ka diferenca ato duhet të eliminohen. Lidhur me këtë proces të analizohet fillimisht nëse ka nevojë për trajnime për Zyrtarin e Pasurisë.	Komuna edhe me teje ka ngecje në regjistrimin e pasurisë në përdorimin e modulit të sistemit të E-pasurisë.	Nuk është zbatuar.
11	Depozitimi i parasë së gatshme	Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se depozitat e përditshme të parasë dhe kontrollet janë kryer ashtu siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.	Edhe gjatë këtij viti kemi vërejtur se depozitimi i mjeteve të inkasuar nuk janë depozituar në afatin e përcaktuar sipas dispozitave ligjore.	Nuk është zbatuar.
12	Nënvlerësim i llogarive të arkëtueshme të shpalosura në PFV	Kryetari duhet të forcoj kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e llogarive të arkëtueshme. Fillimisht duhet të ekzistojë një sistem i përshtatshëm i regjistrimit dhe raportimit të tyre si dhe të sigurojë se do të merren të gjitha veprimet e nevojshme për të rritur nivelin e arkëtimit të të arkëtueshmeve.	Edhe gjatë këtij viti saldot e llogarive të arkëtueshme nuk janë harmonizuar dhe llogarit e arkëtueshmeve nuk janë prezentuar saktë në PVF.	Nuk është zbatuar
13	Nën vlerësim i obligimeve	Kryetari duhet të forcoj kontrollet lidhur me menaxhimin dhe raportimin e obligimeve të papaguara. Fillimisht, duhet të siguroj mbajtjen e një libri të protokollit, ku do të regjistrohen dhe protokollohen të gjitha faturat e pranuar. Me tutje të krijojë një sistem efektiv në të cilin të gjitha faturat e papaguara raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë në baza mujore në MF, si dhe në fund të çdo viti shpalosen saktë në PFV.	Gjatë këtij viti të gjitha raportimet janë bërë me afatin e caktuar kohor, po ashtu pas përfundimit të fazës së ndërmjetme të auditimit, është caktuar edhe zyrtari për protokollimin e faturave.	Është zbatuar.

14	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimëve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm	Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.	Disa nga rekomandimet nuk janë zbatuar por disa janë në proces të zbatimit.	Rekomandimi i mbyllur.
15	Mungesa e themelimit të NJAB-së	Kryetari duhet të sigurojë përmbushjen e kërkesës ligjore, respektivisht të rekrutojë një auditor të brendshëm. Nëse kjo kërkesë nuk mund të realizohet, atëherë shërbimi i auditimit të brendshëm, të kryhet nga Ministria e Financave, apo ndonjë subjekt tjetër publik. Shërbimi i auditimit, do të mbështeste menaxhmentin në vendimmarrje dhe eliminim të dobësive.	Komuna nuk ka ndërmarr as një aktivitet për ta përmirësuar situatën.	Nuk është zbatuar.
16	Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili mund të nxirren të gjitha informatat relevante që ndikojnë në vendimmarrjen cilësore dhe me kohë të menaxhmentit. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartojë regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.	Mos regjistrimi i pasurisë, mos monitorimi i listës së rreziqeve, niveli i lartë të arkëtushmeve, janë fakte se nuk është përcaktuar dhe kryer një raportim i mirë.	Nuk është zbatuar.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV	Kryetari duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar arsyet për theksim të çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për të adresuar dobësitë e rëndësishme në një mënyrë sistematike dhe pragmatike për të zbutur dobësitë e shpalosura në theksimin e çështjes të opinionit të auditimit. Gjithashtu kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		

2	Të hyrat- Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë	Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parasheh ligji në mënyrë që në bazën e të dhënave të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale të pronat të vlefshme për bazën e tatueshme si dhe duhet të vendos kontrolle të qëndrueshme që sigurojnë një arkëtim efektiv të të hyrave, duke përfshirë dhe përcaktuar vlerësimin e drejtë të barrës tatimore në përputhje me rregullat dhe gjendjen faktike në teren.
3	Mungesë e dosjeve të personelit dhe pagesa pa bazë ligjore.	Kryetari duhet të adresoj çështjen e mëtejme të këtyre pagesave, në MAP dhe MF ose të siguroj rishikimin e mundësisë që këta zyrtarë të transferohen në institucionet ku ata punojnë, ose të kompletohen dosjet e tyre në komunë për të krijuar bazë ligjore për kompensimin e pagave.
4	Dosjet e pa azhurnuara të personelit	Kryetari të sigurohet se drejtoret e institucioneve arsimore, kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës.
5	Mungesa e rregullores për ndarjen e subvencione ve.	Kryetari duhet të siguroj hartimin e një rregullore për procesin e subvencionimit të gjitha aktiviteteve, dhe e cila specifikon qartë kriteret për subvencionim dhe e njëjta të aprovohet në Kuvend Komunal.
6	IK- Tejkalmi i pozicioneve të paramasës së kontraktuar	Kryetari duhet të sigurohet që fillimisht projektet ekzekutive janë të qëndrueshme dhe të planifikuara mirë, në mënyrë që mos të lejohen tejkalime-ndryshime të pozicioneve të para masave paraprakisht të kontraktuara. Në të kundërtën çdo ndryshim jashtë procedurave ligjore përbën shkelje të kontratës nëse paraprakisht nuk sigurohet miratimi nga menaxheri i prokurimit dhe ZKA.
7	Mungesa e procedurës së brendshme dhe regjistrit të pasurisë nën 1,000€	Kryetari duhet të siguroj se procesi gjithë përfshirës i regjistrimit të pasurive do të vazhdoj dhe brenda një afati optimal dhe pas përfundimit të procesit të përgatit një raport përfundimtar mbi gjendjen e pasurive, të cilin duhet ta harmonizoj me regjistrat kontabël të komunës. Kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e tyre duhet të aplikohen në tërësi, të siguroj një evidencë të saktë të inventarit, të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme me vlera nën 1,000€ të bëhen përmes sistemit E-pasuria dhe të siguroj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare.
8	Depozitimi i vonuar i parasë së gatshme	Kryetari të sigurohet se kontrollet janë vendosur dhe funksionojnë bazuar në kërkesat ligjore dhe arkatarët apo zyrtarët kompetent që mbledhin paratë publik si të hyra ti depozitojnë brenda afateve të parapara ligjore.
9	Rritja e nivelit të të arkëtueshme ve	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

10.	Mos ekzekutimi i pagesave në afatin ligjor	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave për të siguruar që faturat paguhen brenda afatit ligjor.
11	Mos themelimi i NJAB-së	Kryetari duhet të siguroj përmbushjen e kërkesës ligjore, respektivisht të rekrutoj një auditor të brendshëm. Nëse kjo kërkesë nuk mund të realizohet, atëherë shërbimi i auditimit të brendshëm, të kryhet nga Ministria e Financave, apo ndonjë subjekt tjetër publik. Shërbimi i auditimit, do të mbështeste menaxhmentin në vendimmarrje dhe eliminim të dobësive.
12	Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili mund të nxirren të gjitha informatat relevante që ndikojnë në vendimmarrjen cilësore dhe me kohë të menaxhmentit. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe zbatimin e planit të prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.



Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.



158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Letër e Konfirmimit



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës

Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

#### Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Mamushës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

**z. Abdülhadi Krasniç**

Kryetar i Komunës,

Datë: 17 Qershor 2019, Mamushë

